



---

## **Hapet Thirrja për Mobilitete (Bursa) studentësh dhe staf të FAU, në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus +, në Universitetin e Venezias IUAV, në Itali**

Në kuadrin e marrëveshjes dy palëshe të FAU dhe Universiteti IUAV i Venezias, “An Implementation Agreement for Academic Cooperation for Setting Up a Double Degree”

dhe në kuadrin e programit Erasmus+ KA 1, është hapur thirrja për aplikime për Bursa, për studentët dhe stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, të cilët mund të kryejnë studime apo mesimdhënie pranë Universitetit IUAV të Venezias, në Itali.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbim studentësh të nivelit Master për studime
- Shkëmbim stafi për mesimdhënie
- Shkëmbim stafi administrativ / mesimdhënës për trajnim.

### **Niveli i mobilitetit për studentët:**

- **Master Shkencor.** (studentët duhet të jenë të regjistruar në një Program të integruar studimi të ciklit të dytë, Master Shkencor, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, dhe në momentin e aplikimit, duhet të jenë studentë të rregullt në vitin e 4).

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- **Student:** 1 vit akademik, (11 muaj: 1 shtator 2021 - 31 Korrik 2022). (studentët do të kryejnë vitin e fundit të studimeve, në Universitetin pritës, dhe në fund të vitit do të marrin diplomë të dyfishtë).
- **Staf për mesimdhënie:** 7 ditë + 2 ditë udhëtim
- **Staf për trajnim:** 5 ditë + 2 udhëtim

### **Fusha e studimit:**

- **Arkitekturë**
- **Urbanistikë**

Numri total i studentëve: **3 studentë**

Numri total Staf për mesimdhënie: **2 pedagogë**

Numri total Staf për trajnim: **1 staf**



**Key Action 1**  
**- Mobility for learners and staff -**

---

**Kushte paraprake për studentët:**

Studentët duhet të kenë fituar të 180 kreditet e 3 viteve te para. Gjatë procesit të seleksionimit të kandidatëve, do të jenë fitues ata studentë që nuk kanë lëndë të mbartura për frekuentim, dhe nuk kanë asnjë provim të mbartur deri ne momentin e aplikimit.

**Dokumentat e nevojshme për aplikim, për studentët:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj ( Italisht CELI, ose Anglisht TOEFL/CEFR, B2 )\*;
- Dokumenti Learning Agreement\*\*

\* *Niveli minimal i kërkuar për të dyja gjuhët është B2. Nëse do të përzgjidhen lëndë që zhvillohen në të dyja gjuhët, studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar për të dyja këto gjuhë duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

\*\**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin në Venezia, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në vitin përkatës në Fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

*Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement” klikoni si më poshtë:*

[https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement\\_en](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement_en)

*për të patur informacion mbi lëndët që zhvillohen në Universitetin e Venezias, klikoni në:*

<http://www.iuav.it/Didattica1/lauree/MAGISTRALI/ARCHITETTU/>

**Dokumentat e nevojshme për aplikim, për staf:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Dokumenti Staff Mobility for Teaching Mobility Agreement;
- Niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2. (Italisht ose Anglisht).

**Afati për aplikim: deri më 28 Qershor 2021 ora 14.00**

Aplikimi kryhet pranë Sekretarisë Mësimore të FAU.